



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:198414
Datë: 04.04.2024
Numri i dokumentit: 05546071

C.nr.140/2015

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni civil, me gjyqtarin Fuad Haliti, në kontestin e paditëses Komuna e Mitrovicës Jugore, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av.Lirim Zeka, kundër të paditurit V...Z... nga fshati M..., Mitrovicë, tani me adresë të ndryshuar, me objekt kontesti, pas mbajtjes së seancës kryesore, me datë 04.04.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** kërkesëpadia e paditëses Komuna e Mitrovicës Jugore në tërësi si e bazuar.
- II. OBLIGOHEN** i padituri V...Z... nga Mitrovica që paditëses t'ia paguajnë borxhin në lartësi prej 220.32€, në emër të kompensimit të dëmit, në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.
- III. OBLIGOHEN** i padituri V...Z... nga Mitrovica që paditëses t'ia kompensoj shpenzime e procedurës kontestimore në lartësi prej 101.40 €, në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Arsyetim

Komfor nenit 423 paragrafi 4 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, shqyrtimi gjyqësor është mbajtur në mungesë të të paditurit.

1. Pretendimet e palëve

Paditësja me datën 16.03.2016 pranë kësaj gjykatë ka paraqitur padi me të cilën ka kërkuar që të obligohet i padituri që t'ia kompensoj shumën në lartësi prej 220.32€, në emër të kompensimit të dëmit.

Në seancën kryesore i autorizuari i paditëses deklaroi se mbes në tërësi pranë padisë duke kërkuar nga gjykata që të nxjerr aktgjykim me të cilin e obligon të paditurin që të paditurës në emër të dëmit të shkaktuar si pasojë e dëmtimit të pyllit t'ia paguaj shumën prej 220.32€, kjo pasi që i njëjti sipas aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Divizionit për Kundërvajtje K.nr.8635/14 është shpallur përgjegjës pasi që i njëjti ka dëmtuar pyllin në pronësi të të

paditurës. Shpenzimet e proceurës i kërkojë dhe atë për përfaqësim në seancë shumën prej 104.40€.

2. Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: aktvendimin K.nr.8635/2014 i datës 22.12.2014, kërkesa nr.78/14 e datës 21.07.2014 dhe fletëparaqitja për dëmin e pyllit e datës 21.07.2014.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku duke gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e **bazuar**.

3. Faktet

Me leximin e aktvendimin K.nr.8635/2014 i datës 22.12.2014, kërkesa nr.78/14 e datës 21.07.2014 dhe fletëparaqitja për dëmin e pyllit e datës 21.07.2014, gjykata vërtetojë faktin se i paditurë është i denuar me aktvendim të formës së prerë për shkak se me datën 05.07.2014, në rajonin e fshatit M... ka dëmtuar pyllin duke e prerë dhe atë vlera e pyllit të dëmtuar ka qenë në shumën prej 220.32€, procedurë kjo e cila është inicuar në bazë të kërksës së Drejtorisë së Mbrojtjes së Mjedisit dhe Pyjeve të Komunës së Mitrovicës.

4. Ligji i aplikueshëm

Në bazë të nenit 136 paragrafi i Ligjit për Marrëdhënit Detyrimore, parashihet që *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij.”*

Në bazë të nenit 137 të Ligjit për Marrëdhënit Detyrimore, parashihet që *“Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material).”*

5. Vlerësimet përfundimtare të gjykatës

Pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të administruara në këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe se duke u bazuar në dispozitat ligjore të cituara më lartë, e njëjta duhet të aprovohet.

Gjykata në bazë të provave të administruara, vërtetojë faktin se i padituri V...Z... me datën 05.07.2014, në vendin e quajtur M... e Z... në fshatin M..., ka dëmtuar pyllin duke prerë dru të

llojit Ahu, me vëllim të përgjithshëm prej 1.44 m³ dhe për këtë është dënuar me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë K.nr.8635/2014 i datës 22.12.2014. Me këtë rast, i padituri sipas dispozitës së nenit 136 paragrafi i Ligjit për Marrëdhënit Detyrimore ka për obligim që paditëses t'ia kompensoj dëmin që i'a ka shkaktuar me prerjen e druve pa leje adekuate të lëshar nga paditësja.

Lidhur me shpenzimet procedurale, gjykata vendosi komfor nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së, duke marrë parasysh se e padituri e humbi këtë kontest.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil
C.nr.140/2015, datë 04.04.2024

Gjyqtari
Fuad Haliti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite pas marrjës së të njejtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2019:198414
Datë: 04.04.2024
Numri i dokumentit: 05546071